



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
Ministarstvo Kulture, Omaladine i Sporta
Ministry of Culture, Youth & Sports

Sfond për projektin “Kujtesa e Kosovës: Rrëfimet e të mbijetuarve të masakrës së Krushës së Madhe”:

Projekti “Kujtesa e Kosovës: Rrëfimet e të mbijetuarve të masakrës së Krushës së Madhe” realizohet nga Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani” dhe nga Fakulteti Filozofik, Dega e Antropologjisë. Ky projekt synon të mbledhë, të dokumentojë, të publikojë dhe të promovojë rrëfime të të mbijetuarve dhe dëshmitarëve okularë të masakrës së Krushës së Madhe në komunën e Rahovecit në Kosovë. Deri në treqind [300] intervista të historisë gojore do të realizohen me qëllim të mbledhjes së kujtimeve dhe rrëfimeve të dëshmitarëve okularë të masakrës. Mbledhja e intervistave audio dhe video, si dhe e materialeve të tjera relevante, do të mundësojë një pasqyrë të masakrës së Krushës së Madhe, do të kontribuojë në zgjerimin e njohurive, si dhe në të kuptuarit më mirë të asaj që kjo masakër la pas.

Ne mbështetje të projektit të historisë gojore “Rrëfimet e të mbijetuarve të masakrës së Krushës së Madhe” projekt që mbështetet nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe zbatohet nga Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”
Shpall

KONKURS

Për rekrutimin e 30 intervistuesve dhe transkriptuesve për projektin e historisë gojore “Rrëfimet e të mbijetuarve të masakrës së Krushës së Madhe”

I.

Institucioni: Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sport/ Biblioteka Kombëtare e Kosovës

“Pjetër Bogdani”

Titulli i punës: Intervistues dhe transkriptues në projektin e historisë gojore “Rrëfimet e të mbijetuarve të masakrës së Krushës së Madhe”.

Institucioni: Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

Kategoria funksionale /Koeficienti:

Një intervistë = 50.00 Euro

Një transkriptë = 50.00 Euro

Gjithsej do të realizohen 300 intervista

Numri i referencës: 01/2021

Vendi: Prishtinë

Detyrat dhe përgjegjësitë:

1. Të ndjekin të gjitha trajnimet e organizuara në kuadër të projektit .
2. Të marrin pjesë në identifikimin e të intervistuarve.
3. Realizimi i intervistave me standarde të larta etike dhe profesionale.
4. Transkriptimi i intervistave në mënyrë autentike dhe të saktë.

Shkollimi i kërkuar, përvoja, aftësitë dhe karakteristikat personale:

1. Të diplomuar ose në vitin e fundit të studimeve në Fakultetin Filozofik apo në Fakultetin Filologjik.
2. Të dorëzohet një CV me detaje të shkollimit dhe përvojës, veçanërisht përvojës dhe angazhimit paraprak në realizimin e intervistave në terren.
3. Së paku një rekomandim që dëshmon përvojën në këtë fushë.

Përzgjedhja e kandidatëve:

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet nga komisioni profesional përmes intervistimit të secilit kandidat që i plotëson kushtet dhe kriteret e përcaktuara në këtë konkurs.

Procedurat e konkurrimit:

Konkursi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar që i plotësojnë kriteret e përcaktuara në konkurs.

Kohëzgjatja e emërimit: 1 vit

INFORMATË E PËRGJITHSHME PËR TË GJITHË KANDIDATËT

Data e aplikimit është nga 04.02.2021

Dokumentacioni i kandidatëve duhet të dërgohet deri me 12.02.2021 në adresën:

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit /Departamenti Trashëgimisë Kulturore/Biblioteka Kombëtare e Kosovës“ Pjetër Bogdani “ për projektin:

“Kujtesa e Kosovës: Rrëfimet e të mbijetuarve të masakrës së Krushës së Madhe”:

Zyra Nr. 22 Adresa : Sheshi “ Nëna Terezë “ Nr. 35, Prishtinë.